



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Leje Ndërtimore



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/02-19949

Dt.12.03.2024.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Shpresa (Haki) Pruthi, Dori (Ylber) Pruthi dhe Ari (Ylber) Pruthi nga Gjakova.		
Adresa:	Rruga "Skenderbeu" nr 49.		
Telefoni:	049 135 381	Emaili:	

Emri i Projektit:	Ndërtimi i anekseve të objektit ekzistues me etazhitet P+3, i cili posedon me Leje Ndërtimi – Aktvendimi nr.07/351-5315 dt. 15.09.2009 dhe mbindërtimin me etazhitet nga P+3 në P+5+KSH.		
Emri i Projektuesit:	"A & C ENG SH.P.K" - Gjakovë.		
Adresa:	Rruga "Ferhat Binishi" pn.		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:			
Adresa: Rruga "Skendebeu".			
Zona(t) Kadastrale: Gjakovë-Qytet	Nr. i parcelave kadastrale: 2636-1,2636-5(gjendja e re)	GPS Koordinatat:	

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☒	Kategoria II ☐
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☒
Përshkrimi: Lejohet ndërtimi i anekseve të objektit ekzistues me etazhitet P+3, i cili posedon me Leje Ndërtimi – Aktvendimi nr.07/351-5315 dt. 15.09.2009 dhe mbindërtimin me etazhitet nga P+3 në P+5+KSH.	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Shpresa (Haki) Pruthi, Dori (Ylber) Pruthi dhe Ari (Ylber) Pruthi nga Gjakova**, i lejohej ndërtimi i anekseve të objektit ekzistues me etazhitet P+3, i cili posedon me Leje Ndërtimi – Aktvendimi nr.07/351-5315 dt. 15.09.2009 dhe mbindërtimin me etazhitet nga P+3 në P+5+KSH, sipas lokacionit të dhënë, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) për ndërtim pas revidimit **S= 555.41 m²**.

Përdhese - aneksi:	(Sip,Bruto):	S= 1.8 m²
Kati i parë - aneksi:	(Sip,Bruto):	S= 38.24 m²
Kati i dytë - aneksi:	(Sip,Bruto):	S= 30.42 m²
Kati i tretë - aneksi:	(Sip,Bruto):	S= 30.42 m²
Kati i katërt:	(Sip,Bruto):	S= 155.38 m²
Kati i pestë:	(Sip,Bruto):	S= 155.38 m²
Kulmi i shfrytëzueshëm:	(Sip,Bruto):	S= 143.77 m²

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha faza për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollat e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi: **Shpresa (Haki) Pruthi, Dori (Ylber) Pruthi dhe Ari (Ylber) Pruthi nga Gjakova** përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-19949 të datës 06.10.2023, të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin i anekseve të objektit ekzistues me etazhitet P+3, i cili posedon me Leje Ndërtimi – Aktvendimi nr.07/351-5315 dt. 15.09.2009 dhe mbindërtimin me etazhitet nga P+3 në P+5+KSH, sipas lokacionit dhe projektit të prezantuar, në ngastrën kadastrale me nr. 2636-1,2636-5(gjendja e re) ZK: Gjakovë-Qytet, në pronësi të përbashkët të Shpresa (Haki) Pruthi, Dori (Ylber) Pruthi dhe Ari (Ylber) Pruthi nga Gjakova.

DUMM, përkatësisht zyrtari përgjigjes për lëndën, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Plani i Situacionit 1: 500 i vërtetuar nga DUMM, dt. 12.02.2024 (Lokacioni i reviduar).
- Kopjen e planit (fotokopje) së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) në pronësi të përbashkët të Shpresa (Haki) Pruthi, Dori (Ylber) Pruthi dhe Ari (Ylber) Pruthi nga Gjakova të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Lejen ndërtimore – Aktvendimi me nr. 07/351-5315, dt. 15.09.2009, lëshuar nga DUMM së bashku me Planin e Situacionit të datës 10.07.2009.
- Vërejtje: Meqenëse objekti është aktiv, zyrtari përgjegjës për lëndën konstaton se nuk ka nevojë për pëlqime shtesë, për kyqje në infrastrukturën komunale, andaj vlejnë të gjitha të prezantuara në lejen paraprake.
- Raportin sqarues nga zyrtari përgjegjës për lëndën – Urbanisti.
- Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Vllesë – co, filiali në Gjakovë me datë 13.02.2024.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga “A & C ENG SH.P.K ” - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 1990.72 Euro.

- **Shtojcë:** Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: Plani i Situacionit së bashku me kushte lokacioni, me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, në përpjesë 1:500 të datës dt. 12.02.2024 të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Arkivit.

Hartoi aktin

Zenel Shabani Z.L. Ligjor

Zyrtari përgjegjës për lëndë

Mirlinda Mullahasani I.D.A.

Drejtori

Arben Bakalli

